

Tre studentët myslimanë-amerikanë të cilët u vranë në rezidencën e Universitetit të Karolinës së Veriut në Chapel Hill, kanë shkaktuar diskutim masiv në mediat sociale. Ndonëse mediat gjigande po mundohen të hedhin ujë mbi këtë zjarr, janë mediat sociale ato që po e mbulojnë si është më së miri krimin e fundit islamofob.

Facebook është mbushur nga hashtaget #ChapelHillShooting dhe #MuslimLivesMatter. Hashtaget janë përdorur nga miliona përdorues, të cilët personalisht kanë denoncuar masakrën ndaj studentëve të rinj mysliman.

Terroristi 46 vjeçar Craig Stephen Hicks u arrestua dhe u akuzua për vrasje. Policia Chapel Hill tha se një hetim fillestar tregon se "krimi ishte i motivuar nga një mosmarrëveshje e vazhdueshme për parkim," por ky arsyetim që e bene policia nuk mund ta fsheh që vrasesi vazhdimisht kishte postuar mesazhe anti-fetare në mediat sociale.

Edhe pse mediat hezitojnë të pranojnë se ky është krim i urrejtjes, një gjë e tillë po dëshmohet edhe nga kolegët e viktimave, të cilët i kanë përshkruar viktimat si njerëz tejet pozitiv dhe human. /mesazhi/